



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*  
*Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*  
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

<b>DATË/A:</b>	20.12.2024
<b>REFERENC-Ë:</b>	22/4324/MMPHI
<b>PËR/ZA/TO:</b>	"ESSE" Sh.p.k. Prizren
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Izedin Bytyqiu, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e ka shqyrtuar kërkesën për Pëlqim Mjedisor të dërguar nga kompania e Juaj me nr.prot.: 24/4324/453/DMMU, dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj letërpërcjellëse.

Vendimi për Përfundim të procedurës administrative të kërkesës së Kompanisë "ESSE" Sh.p.k. Prizren - për Fabrikën për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe "Uji Sharri" në Kaçanik.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*  
*Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*  
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm /Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive Shtetërore, duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit Nr.08//L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, mbështetur në mendimin profesional të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Vendimi Nr.3958/23 datë 13.07.2023), në pajtim me shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

## V E N D I M

Përfundim të procedurës administrative të kërkesës së kompanisë "ESSE" Sh.p.k. Prizren, e cila ka aplikuar për tu pajisur me Pëlqim Mjedisor për Fabrikën për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe "Uji Sharri" në Kaçanik.

## A r s y e t i m

Gjatë shqyrtimit të kërkesës, Raportit të VNM-së dhe dokumentacionit përcjellës të Kompanisë "ESSE" Sh.p.k. Prizren – për Fabrikën për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe "Uji Sharri" në Kaçanik, është konstatuar mungon dokumentacioni si në vijim:


- Leja ndërtimore e komunës nuk korrespondon me veprimtarinë e kërkesës

Faqe 2 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks.gov.net/mmph>, E-mail: [zsp.mmph@ks.gov.net](mailto:zsp.mmph@ks.gov.net)



Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për VNM, Neni 17, Paragrafi 2, 3 dhe 4, Kompanisë "ESSE" Sh.p.k. Prizren, me datën 21.08.2024 është dërguar njoftimi për plotësim të dokumentacionit.

Bazuar në të lartcekurat, MMPHI merr vendim për **Përfundimin e Procedurës Administrative** të kërkesës për paisje me Pëlqim Mjedisor për "ESSE" Sh.p.k. Prizren, e cila ka për Fabrikën për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe "Uji Sharri" në Kaçanik.

**Shpjegim për palën:** Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për riaplikim sipas procedurës së rregullt.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 22/4324/1- ZSP/ /24 datë: 20.12.2024

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Komunës së Prizrenit
5. Kabinetit të Ministrit
6. Divizioni për komunikim me publikun
7. Arkivit të MMPHI



U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të  
MMPHI

Faqe 3 nga 3